

Lehtësimi/moderimi i takimeve online - informata dhe këshilla

“Lehtësimi/moderimi është arti i udhëheqjes së njerëzve përmes proceseve drejt objektivave të rëna dakord në një mënyrë që inkurajon pjesëmarrjen, pronësinë dhe kreativitetin nga të gjithë ata që janë të përfshirë”

Njiheni veglën tuaj online dhe sigurohuni që të gjithë janë të njohur me mjetet që po përdorni

Pavarësisht sa lehtësues/moderator i mirë jeni në takime ballë për ballë, mbani mend se ambienti online (virtual) kërkon nga ju që të njihni platformën online që jeni duke e përdorur. Testoni sistemin online para fillimit të punës. Përpiquni të njihni atë sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrë që ndjeheni rehat kur e përdorni atë dhe të mund tua shpjegoni të tjerëve. Tregojuni njerëzit që të mësojnë të përdorin butonin "fik mikrofonin" (*ang* mute) - veçanërisht për grupe të mëdha - në mënyrë që të mësohen të kenë mikrofonin e fikur kur nuk flasin; Është e rëndësishme ta testoni paraprakisht dhe të dini funksionalitetet e tij:

- Si të ndani [paraqitni që t'i shohin të gjithë] përmbajtjet, si PPT dhe dokumente të tjera
- Ndarjen e pjesëmarrësve në dhoma online për të punuar në grupe
- Kushtoni vëmendje seksionit të porosive (chat) ku njerëzit bëjnë pyetje dhe komente
- Tjetër...

Angazhoni njerëzit

- **Qëndrimi juaj si moderator/lehtësues** ka më shumë rëndësi se sa që mendoni, sepse njerëzit kanë ndjesi të padukshme nëse ata do të gjykohen, të tallen apo të vihen në ndonjë mënyrë në pozitë të pakëndshme për ato që thonë. Karakteristikat e moderatorit të mirë janë si më poshtë:
 - Një perspektivë e paanshme
 - Ndjeshmëria ndaj ndjenjave të individëve
 - Ndjeshmëria ndaj ndjenjave të grupit
 - Aftësia për të dëgjuar
 - Takti
 - Përkushtimi për bashkëpunim
 - Ndjenja e kohës



- Mprehtësia dhe kreativiteti
- Sensi i humorit
- **Provoni [energizuesit online](#)** : kjo është një listë me një numër aktivitete të shkurtra që mund të përdorni për të nxitur pjesëmarrjen e pjesëmarrësve në takim. Për t'i "zgjuar ata" dhe për tua hequr mendjen nga obligimet e tjera që të mendojnë vetëm për këtu dhe tani. Mos harroni se po e bëni këtë sepse doni t'i mbështesni ata që të përqendrohen në përmbajtjen e takimit. Ata do ta çmojnë këtë në fund sepse duan që të përfitojnë sa më shumë nga koha që e kalojnë në takim. Gjithashtu, kur zgjidhni një [aktivitet] energizues mendoni se çfarë jeni duke u përpjekur të arrini me të dhe çfarë lloji njerëzish e përbëjnë grupin tuaj, të njihni energizuesin që e përdorni dhe të ndjeheni rahat me të.
- Ju gjithashtu dëshironi të mbani të ashtuquajturën "**hapësirë të sigurt**" ku ata mund të shprehin sfidat dhe shqetësimet e tyre në mënyrë të hapur. Ekzistojnë pesë nevoja themelore njerëzore që duhet t'i mbani mend kur e moderoni/lehtësoni një ngjarje:
 - Të jenë të përfshirë
 - Të ndihen të sigurt
 - Të kenë të drejtë
 - Të jenë kompetent
 - Të jenë të vlerësuar
- Përpiloni një agjendë që krijon një **ekuilibër në mes të prezantimeve dhe punës në grupe**. Ndiqni të ashtuquajturin PowerPoint Minimal Viable (MVP) ose me fjalë të tjera, zgjidhni sasinë më të vogël të të dhënave që ju nevojiten për të informuar dhe angazhuar grupin. Për shembull, në vend që të kaloni 30 minuta duke folur për një teknikë të menaxhimit të kohës, mund t'i bëni njerëzit ta provojnë atë. Shpjegojeni atë shumë shkurtimisht në 10 minutat e para, jepuni njerëzve mundësi për të praktikuar veglën në grupe të vogla për 10 minuta, dhe pastaj të paraqesin përvojën e tyre edhe për 10 minuta të tjerë. Koha e njëjtë rezulton me një të mësuar shumë më të thellë sesa nëse njerëzit vetëm do të kishin dëgjuar të flitej për të.
- **Inkurajoni reagimet/komentet**. Mbështetuni në karakteristikat tuaja të moderimit të shënuara më lart dhe inkurajoni komentet e singerta dhe kritike jo vetëm nga palët kryesore të interesit, por nga i gjithë grupi. Mund të jetë mirë që të merren komentet jo vetëm pas një seance por edhe pasi të ketë kaluar ca kohë dhe kur disa nga veprimet e adresuara gjatë një seminari të jenë zbatuar. Po ashtu, respektoni të ashtuquajturën



rregull 5-minutëshe, që do të thotë se nuk duhet të kalojnë më shumë se 5 minuta pa i dhënë grupit një problem tjetër për të zgjidhur. Inkurajoni ekspertët që të përfshijnë pjesëmarrësit. P.sh. Në një prezantim 15 minutash duhet të ketë 2-3 mundësi të shkurtra, të definuara mirë dhe kuptimplota të angazhimit. Për shembull, ju mund të përfundoni prezantimin me një listë opsionesh të krijuara në grup, pastaj të organizoni një sondazh/mundësi votimi për të përcaktuar mendimin e ekipit se ku duhet filluar.

